

RAPORT I SHKURTËR

“Rritja e efikasitetit të buxhetit të shtetit përmes zbatimit të konsultimit publik në sektorin e drejtësisë”

Periudha e projektit: prill – dhjetor 2019

1) Arritjet e projektit parë nga këndvështrimi i organizatës tuaj

Në kuadër të projektit “Rritja e efikasitetit të buxhetit të shtetit përmes zbatimit të konsultimit publik në sektorin e drejtësisë” të financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Qendra Europiane vlerëson se është arritur:

- a) Rritje e financimit të programit Ndihma Juridike e Garantuar nga Shteti në buxhetin e miratuar për vitin 2020 me 1,000,000 lekë krahasuar me parashikimet në PBA Faza I dhe Faza Teknike;
- b) Advokim dhe koordinim bashkëpunues mes Qendrës Europiane Ministrinë e Drejtësisë;
- c) Angazhim i organizatave partnere në fushën e Ndhmës Juridike Falas në vlerësimin e prioriteteve dhe ndërhyrjeve advokuese në këtë proces;
- d) Ndarja e eksperiencës me organizatat partnere dhe rritja e kapaciteteve të tyre sa i takon Programit Buxhetor Afatmesëm.

2) Vështirësitë e hasura gjatë projektit

Gjatë zbatimit të këtij projekti është hasur vështirësi në dy aspekte. Së pari, në mos konsultimin paraprak të PBA 2020-2022 Faza I për Ministrinë e Drejtësisë, pasi MD nuk e kish gati dokumentin në ditën e organizimit të seancës konsultuese. Mungesa e këtij dokumenti natyrisht ka sjellë vonesa në procesin e analizimit dhe konsultimit me organizatat partnere dhe më pas ndarjen e vlerësimeve dhe rekomandimeve me MD.

Së dyti, vështirësi është hasur në komunikimin me Ministrinë e Financave, e cila ka qenë tërësisht në shkelje të të gjitha parashikimeve ligjor të Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtëjn e informimit” dhe Udhëzimit nr. 8 datë 28.2.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë lidhur me procesin e konsultimit me shoqërinë civile dhe pasqyrimin/argumentimin e sugjerimeve të tyre.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka shfaqur një rol tërësisht pasiv në lidhje me procesin e konsultimit të PBA 2020-2022 me shoqërinë civile, pozicion ky i cili nuk mund të justifikohet me ngarkesën e punës që kjo ministri mban.

3) Çfarë do kishim bërë ndryshe

Në lidhje me të gjithë procesin vlerësojmë se duhet të kishim ndërhyrë, që në fazën fillestare të përgatitjes së tavanëve buxhetore dhe miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave. Përfshirja dhe angazhimi që në atë fazë do bënte të mundur rezultate finale më të mira.

4) Si mendoni ta realizoni vetë vitin e ardhshëm buxhetimin me pjesëmarrje?

Qendra Europiane synon të angazhohet në mënyrë të ngjashme si gjatë vitit 2019, duke shtuar këtu angazhimin që në fazën e kërkesave dhe miratimit të tavanëve buxhetore.

Presion pozitiv më i madh synohet të bëhet në lidhje me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

5) Si mendoni duhet të strukturohet një ndërhyrje e rradhës?

Vlerësojmë se ndërhyrja e rradhës duhet të strukturohet në dy drejtime. Së pari, në monitorimin e zbatimit të buxhetit të programeve për të cilat u lobua në 2019, kjo vlen veçanërisht për programin Ndhim Ligjore e Garantuar nga Shteti, pasi do zbatohet për herë të parë. Së dyti, ndjekja e të njëjtit ushtrim për të bërë ndryshime për vitet e ardhshme në rastet kur rritja e buxhetit ka ndodhur vetëm për 1 vit dhe jo për gjithë planifikimin e PBA-së 2020-2022.